



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 23.03.2012, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura, më 10.03.2012 dhe 12.03.2012;
3. Diskutim për përmbushjen e obligimeve nga Plani i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrimet Evropiane
4. Njoftimi i Komisionit për vizitën në Gjermani ;
5. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura, më 10.03.2012 dhe 12.03.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së miratoi Procesverbalet e mbledhjes së mbajtur më 10.03.2012 dhe 12.03.2012 pa vërejtje.

3. Diskutim për përmbushjen e obligimeve nga Plan i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integrimet Evropiane.

Kryetari i Komisionit- Për këtë pikë të rendit të ditës e hap diskutimin për shtrimin e çështjeve në këtë drejtim.

Koordinatori i Komisionit, Nur Çeku- Sipas Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropiane për raportim tremujor, për këtë qëllim Ministrisë së Punëve të Brendshme i është dërguar një listë me pyetje të cilës i janë përgjigjur, ky Raport i është përcjell Komisionit për Integritet Evropiane. Kjo sa i përket tremujorit të kaluar, ndërsa për tremujorin e ardhshëm nëse ka Komisioni ndonjë mekanizëm si takimi me Ministrin ose çdo hap tjetër në këtë drejtim.

Kryetari i Komisionit- Si Komision kemi kryer obligimet në këtë drejtim, kemi marrë Raporte nga Ministritë që i mbikëqyrin, Inspektorati Policor dhe i kemi shqyrtuar. Në bazë të Planit të Veprimit ne si Komision do të vazhdojmë ti thërrasim edhe në dëgjim publik. Nëse e vlerësojmë që pas çdo Raporti të ftohen ose jo Ministrat e Ministrive përkatëse mund ti ftojme.

Fatmir Xhelili- Mendoj që Komisioni duhet të ketë një rol mbikëqyrës për aktivitetet e propozuara për proces të liberalizimit dhe proces të integriteteve evropiane në mënyrë që të përmbushen obligimet për këtë proces, shikuar edhe në analizën e bërë nga Raporti i Progresit për aktivitetet jo të mjaftueshme.

Përmes mbikëqyrjes së ligjeve, informimit nga media mund të identifikojmë lëshimet në përmbushjen e obligimeve të segmenteve të sigurisë bazuar në Planin e Veprimit për Integritet Evropiane, prandaj mendoj që është e drejtë të ndikojmë si Komision qoftë në thirrjen e Ministrave të Ministrive përkatëse ose personave përgjegjës të Agjensioneve për zbatimin e ligjit për të nxitur kryerjen e aktiviteteve të planifikuara.

Vjollca Krasniqi- Në raportimin e bërë nga Ministria e Punëve të Brendshme, në tabelën përmbledhëse për rastet e trafikimit të qenieve njerëzore kosovare thuhet që është në rritje e sipër e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore, një tregues i tillë për vitin 2011 duhet kuptuar si punë më aktive nga Policia e Kosovës apo ka ndonjë shpjegim tjetër, prandaj mendoj që duhet të marrim një informacion më të detajuar nga Policia e Kosovës.

Fatmir Xhelili- Sa i përket çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore është përhapur edhe në media vendore dhe ndërkombëtare se në Kosovë një gjë e tillë është në nivel të lartë. Numrat nuk janë parametra kualitativ për të treguar situatën reale në vend por vështirësi e Kosovës ka qenë krijimi i mekanizmit kundër trafikimit, ky mekanizëm tani është krijuar dhe funksionon mirë me të gjitha segmentet e zbatimit të ligjit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme etj.

Sektori i gjyqësisë mund të konsiderohet pak më dobët për aplikimin e dënimeve të nivelit të lartë për ata që merren me trafikim, por e rëndësishme është që Kosova tani e ka mekanizmin kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe është në drejtim të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar. Prandaj numrat në rritje janë produkt i kualitetit të segmenteve të krijuara për këtë qëllim.

Kryetari i Komisionit- Krahas shifrave, cilido institucion duhet të jep sqarimet përkatëse, për këtë arsye bëhen edhe dëgjimet publike kur e vlerëson Komisioni, por vlerësojmë që Raporti konsiderohet i në nivel të lartë ku në bazë të tij krijojmë vlerësimin tonë për këtë institucion. Konsideroj se tani kemi një efikasitet më të madh në Policinë e Kosovës dhe kjo vërehet me shtimin e numrit të veprimeve të Policisë dhe kjo ka ndikuar që numrat të jenë të ndryshëm nga ata që kanë qenë më herët.

Nëse nuk keni për të shtuar për këtë Raport ju falënderoj për kontributin, konsiderojmë që Raporti është i një niveli të mirë dhe se Raporte të tilla e ndihmojnë veprimtarinë e Komisionit për të parë funksionimin e këtyre institucioneve të sigurisë.

4. Njoftimi i Komisionit për vizitën në Gjermani

Kryetari i Komisionit- Janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura për vizitën e Komisionit në Gjermani në bashkëpunim me GIZ-in, nisja do të bëhet me datën 25 mars 2012

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Me 4 prill 2012, në Kuvendin e Kosovës do të jetë për vizitë zyrtare Komisioni i Mbrojtjes dhe Komisioni i Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Republikës së Hungarisë, pas kthimit nga vizita në Gjermania do të përcaktojmë obligimet e Komisionit për organizimin e këtij aktiviteti dhe vizitat që do të bëhen në institucionet e ndryshme të Kosovës sipas agjendës.

Me 4 prill në Kuvendin e Kosovës do ta vizitojnë Kongresistë amerikan, në këto takime do të marrin pjesë edhe Kryetarët e Komisioneve Parlamentare si dhe nënkryetarët e Komisioneve.

Gjithashtu ju njoftoj që aktiviteti i organizuar nga DCAF-i, në Vjenë të Austrisë, për *funksionimin ndërinstitucional të institucioneve të sigurisë*, datat e ofruara janë 17-22 shator 2012 dhe 24-29 shator 2012.

Për cilën datë jeni të pajtimit të realizohet kjo vizitë?

Pas diskutimeve anëtarët ranë dakord që data e kësaj vizite të jete 17-22 shator 2012 në Vjenë të Austrisë .

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi